



Misioni Shqiptar 'E Lumja Nënë Tereza'

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Për lavdi të Hyjit

6 Prill 2014




Aso here ishte i sëmurë njëfarë Lazri nga Betania, prej fshatit të Marisë e të motrës së saj, Martës. Maria ishte Aajo, që e pati përreruar Zotërinë me erëra të mira dhe ia pati fshirë këmbët me flokët e saj. Pra, vëllai i saj, Lazri, ishte sëmurë. Prandaj motrat i çuan fjalë: “Zotëri, ai që ti e do është i sëmurë.” Jezusi, kur dëgjoi, tha: “Kjo sëmundje nuk është për vdekje, por për lavdi të Hyjit, që të nderohet në saje të saj Biri i Hyjit.” Jezusi e kishte fort për zemër Martën, motrën e saj dhe Lazrin. Megjithatë, kur mori vesh për sëmundjen e tij, u ndal edhe dy ditë në atë vend ku ndodhi. Veç atëherë u tha nxënësve: “Ejani të shkojmë prapë në Jude.” Nxënësit i thanë: “Mësues, tani judenjtë deshën të vrasin me gurë e ti përsëri do të kthehesh atje?” Jezusi u përgjigji: “Vallë, a nuk i ka dita dymbëdhjetë orë? Kush ecën ditën, nuk merr në thua, sepse e sheh dritën e kësaj bote. Kush ecën natën, merr në thua, sepse nuk ka dritë në të.” U tha kështu, pastaj shtoi: “Lazri, dashamiri ynë, fle, por po shkoj ta zgjoj.” Atëherë, nxënësit e tij i thanë: “Zotëri, nëse fle, do të shërohet!” Jezusi u foli për vdekjen e tij, kurse ata menduan se e kishte për gjumë të rëndomtë. Atëherë Jezusi u tha haptas: “Lazri ka vdekur! Jam i kënaqur pse s’ndodha atje, shi për ju, që të besoni! Por, ejani të shkojmë tek ai!” Atëherë Toma, i quajtur Binjak, u tha bashkënxënësve: “Të shkojmë edhe ne të vdesim bashkë me të!” Kur, pra, Jezusi arriti, mori vesh se ai ishte varrosur para katër ditësh. Betania ishte afër Jerusalemit diku rreth pesëmbëdhjetë stadje. Shumë judenjtë kishin ardhur te Marta e Maria për t’i ngushëlluar për vëllanë e tyre. Kur Marta mori vesh se po vinte Jezusi, i doli para, kurse Maria ndenji në shtëpi. Atëherë Marta i tha Jezusit: “Zotëri, të kishe qenë ti këtu, im vëlla nuk do të kishte vdekur. Por edhe tani e di se çkado që të lypësh prej Hyjit, Hyji do ta japë.” “Do të ngjallet vëllai yt!” – i tha Jezusi. “E di se do të ngjallet – i përgjigji Marta – në ringjallje, ditën e fundit.” Jezusi u përgjigji: “Unë jam ringjallja dhe jeta: kush beson në mua, edhe nëse vdes, do të jetojë. Edhe kush jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë. A e beson ti këtë?” Marta

i përgjigji: “Po, Zotëri! Unë besoj se ti je Mesia, Biri i Hyjit, ai që duhej të vijë në botë!” Jezusi, kur e pa duke qarë atë dhe se po qanin edhe judenjtë, që po e përcillnin, u trand në shpirt, u turbullua dhe pyeti: “Ku e keni vënë?” “Zotëri, eja e shih!” – i përgjigjën. E Jezusit i ngufi vaji. Atëherë judenjtë thanë: “Shih, sa e ka dashur!” Disa prej tyre thanë: “A thua ky, që i dha dritën e syve të verbërit, nuk mundi të bëjë që ky të mos vdiste?” Mandej Jezusi, përsëri i tronditur, arriti te varri. Ishte shpellë, e grykën ia kishin zënë me një gurë. Jezusi tha: “Hiqnie gurin!” Marta, motra e të ndjerit, i tha: “Zotëri, tashmë ka marrë erë! Vdiq, qe, katër ditë!” “A nuk të thashë – i përgjigji Jezusi – nëse do të besosh, do ta shohësh lavdinë e Hyjit?” E hoqën, pra, gurin. Jezusi i çoi sytë kah qielli dhe tha: “O Atë, të falënderoj që ma dëgjove uratën. Unë e dija se gjithmonë më dëgjon, por thashë kështu për shkak të popullit që më rrethon: që të besojnë se Ti më dërgove.” Si foli kështu, thirri me zë të madh: “Lazër, dil jashtë!” Dhe, ai që pati vdekur, doli jashtë i lidhur duarsh e këmbësh me rripa pëlthure. Fytyrën e kishte të mbështjellë me rizë. Jezusi u tha: “Zgjidhne dhe lënë të ecë!” Atëherë shumë judenj që kishin ardhur te Maria, kur panë çka bëri Jezusi, besuan në të. *Gjn 11, 1-45*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com ose konsultu harten e ketushme.



Kalendari liturgjik...

07 prill	Shen Gjon Pagezuesi nga Salle
10 prill	Shen Apolloni
12 prill	Shen Juliani
13 prill	E Diela e Larit

Takimi per Kungim te Pare (First Communion) ...

Takimi eshte te dielen 13 prill ne oren 11:15 !

Mbremje per Pashke / Easter Party...

Te dielen e Pashkeve, date 20 prill ne oren 7PM, do te kemi Easter Party !

Kendojne: Liria Dedvukaj, Perparim Mefaja, me Erind Emiri ne tastiere. Per biletat: Luigj Narkaj 647-241-3060, Gjovalin Selmani 647-500-3875, Petrit Ujka (647) 629-7769, Misioni Shqiptar 647-558-9382.

Udha e Kryqit...

Te premten, 11 prill, Udha e Kryqit kremtohet ne mbremje ne oren 7:45

Hakun e Kishes per vitin 2014

e kane dhene **Gjergj Nikolla, Ndok Macaj, Arben Pepa, Benjamin Hasko, Prek Spaqi:**

Aleks	Coku
Altin	Miri
Arben	Toma
Arben	Pepa
Arjana	Nati
Astrit	Simeqi
Aurel	Vata
Beniamin	Hasko
Eduard	Shkreli
Gjergj	Nikolla
Leks	Dragu
Luk	Gjolaj
Marash	Martinaj
Ndok	Macaj
Pjeter & Bep	Dreshaj
Prek	Lekaj
Prek	Spaqi
Sokol	Ujka
Ton	Vocaj
Viktor	Pleti

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese gjate vitit. Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

Ata që erdhën nga prova e madhe (Zb 7,14): një martir shqiptar, shok udhe kah Pashkët, sot, seminaristi Mark Çuni



Mark Çuni (Rranxat e Bushatit, Shkodër, 30.09. 1919 - Shkodër, 04. 03. 1946) pas shkollës fillore, kryer në fshatin e vet, vijoi studimet në Seminarin Papnor të Shkodrës. Nxënës shumë premtues, i pajisur me një mori talentesh, u akuzua si themelues i organizatës “Bashkimi Shqiptar”, u arrestua, u dënua dhe u pushkatua më 4 mars 1946, njëherësh me eprorët e jezuitëve.

Hero i qytetërimit të dashurisë (Sipas dëshmisë së Gjovalin Zezajt) Në prag të Kreshmëve të vitit 1946, dega e sigurimit, që quhej mbrojtja e popullit, ishte në kulmin e veprimtarisë. Proces pas procesi. E në të gjitha këto procese, akuzat më të rënda binin mbi Mark Çunin. Njëherësh me akuzat, mbi trupin e tij rëndonin gjithnjë më shumë torturat. Kur, për të shfryrë inatin se 'nuk i rrëfeva mëkatet', hetuesit më zbritën në katin përdhes e më mbyllën në një banjo të madhe, të ndyrë, primitive, kthyer në vend torture, aty gjeta Mark Çunin. Dergjej pa shtroje pa mbuloje, i katandisur mo'Zo' më keq, me njërin krah të thyer e pa kurrfarë ndihme mjekësore. U mundova ta ndihmoj, si e sa munda. Duke ia lidhur krahun e thyer me një copë të ndyrë peshqiri, pashë se trupi i tij ishte i mbuluar me plagë. Buzët i qenë tharë e plasaritur. Po unë nuk kisha as një pikë ujë, që t'ia freskoja... Kur nisi të bëlbëzonte pak, më tregoi se, në pritje të arrestimit, kishte shkuar tri ditë rresht tek Atë Dajani. I kish kërkuar leje për arratisje. Po jezuiti nuk e kishte lejuar. Madje nuk kishte marrë asnjë masë disiplinore kundër tij, siç ishte zakoni ndër jezuitë, kur ndokush thyente disiplinën e hekurt. Meshtari kishte menduar se gjithçka do të sqarohej. Ndërkaq i kishte nisur seminaristët për pushime verore, sepse kuvendi ishte keq ekonomikisht. Duke i porositur ta mbanin lart petkun, që kishin veshur. E duke menduar se pas pak në seminar do të kthehej jeta normale. Ndonëse e dinte fare mirë kë kishte përballë... Tha kështu e heshti. E u zhytëm të dy në mendime. Nuk e di sa kohë kaluam ashtu, të tulatur pranë e pranë, kur erdhi 'miku i të burgosurve', Fadil Rakiqi, i cili na lajmëroi se kishin arrestuar një prift italian. Të nesërmen, kur Fadili po më shoqëronte në nevojtoje, iu luta të më linte një çast vetëm me klerikun. E ai më çoi nën shkallë, ku pashë një burrë të mbledhur gërmuq. Në fillim nuk e njoha. Thashë emrin tim, e dëgjova një zë, që më gjegji: "Jam atë Giovanni Fausti". Po e takoja për herë të parë, sepse unë ndiqja gjimnazin e shtetit. E kishin rrasur aty, për ta shpersonalizuar, njeriun me personalitet të pathyeshëm! Po ata nuk e njihnin ende. I puttha dorën. Ai më bekoi e më përcolli me fjalët: "Fali, o Zot, se nuk dijnë çka bajnë", thënë butë-butë, me një shqipe të kulluar. Pas disa ditësh, po aty, nën shkallë, do të takoja atë Daniel Dajanin, 42 vjeç, nga Blinishti i Zadrime... Kur e mori vesh arrestimin e dy eporëve, Mark Çuni i harroi dhimbjet e trupit dhe krahun e thyer nga torturat. E brente ndërgjegjja. I dukej se kishte një farë përgjegjësie për këtë katastrofë, pa menduar fare se edhe ai vetë do të zhdukej fizikisht. E kishte parashikuar se kleri do të shkatërrohej, e me të, edhe seminari papnor, Kolegja Saveriane e të gjitha vlerat, që qenë krijuar në atë oazë feje e kulture. Martirizmi kishte nisur që kur nuk i rëndonin ende prangat, me pushkatimin e Dom Ndre Zadejës, të Dielën e Larit, para Pashkëve të përgjakura të vitit 1945. Kur Krishti kryqëzohej në Kalvarin shqiptar. Po e sotmja tregonte se punët po rrokulliseshin keq e mos më keq. Ne, të mbyllurit në atë burg, ishim "Organizata fashiste-terroriste 'Bashkimi Shqiptar', e udhëhequr nga kleri katolik, shkaktar i pushtimit fashist të 7 prillit 1939, komplotist me imperializmin anglo-amerikan, për ndërhyrje, pas shpërthimit të kryengritjes së përgjithshme". Sinqerisht, në kushte më pak serioze, do të kishim qeshur fort për këtë akuzë. Nuk do ta kishim besuar kurrë se ishim aq të zotët, ne, adoleshentët, rritur me Ungjill e uratë në dorë, sa të përmbysnim regjimin më gjakatar, që kishin parë ndonjë herë trojet tona, gjithnjë nën thundër. Sigurisht nuk do të kishim ngurrar ta përmbysnim, po të

mundnim. Me revolucionin e Krishtit, natyrisht. Që na e kishte mësuar Atë Mark Harapi: "Një natë, kur komunistët e armatosur deri në dhëmbë, hynë për të satën herë në Kuvendin e Jezuitëve, majori, që i kryesonte, i drejtohet Atë Mark Harapit, vëlla i Patër Antonit, përkthyes i madh i "Të fejuemve" të Manxoni, me studime të plota kryer në Insbruk, profesor në Kolegjin famëmadhe Saveriane, e me ironi i thotë: 'Hë, ç'keni kundër nesh ju, jezuitët! Ti duhet ta dish më mirë nga unë se komunisti i parë është vetë Krishti'. 'Ashtu asht, u përgjigj Atë Marku. Veçse Krishti lufton me një armë, që ndryshon paksa prej armëve tueja: me armën e dashtënisël'. Më 20 shkurt 1946 u hap seanca e 16-të e gjyqit ushtarak. E fjalës së fundit për 39 të pandehur. Atë Giovanni Fausti, atë Daniel Dajani, atë Gjon Shllaku e tre të rinjtë tjerë, prisnin vetëm dënimin me vdekje. E pas këtij dënimi, të dënuarit do të izolohehin, lidhur me zinxhirë. Ishim thellësisht të pikëlluar, kur Atë Dajani na tha: - Pse nuk po këndonin këngë atdhetare, si përherë? - Si mundemi, Patër- iu gjegji njëri nga ne - kur ju nesër... - Ne - ia preu fjalën Jezuiti, po shkojmë deri në fund të rrugës, që e zgjodhëm vetë. Prandej, e meritojmë të na përcillni me këngë! Nisëm të këndojmë: fjalë e tinguj ngarkuar me lot të valë! Më 4 mars, ditë e hënë, ora 5 e mëngjesit, trupi i Mark Çunit dergjej pa jetë në mes të një mali kufomash, mbi Zajet e Kirit. Zhdukej nën dhe, për të dalë përsëri, nga palci i urrejtjes, si bima prej fare në pranverë, ndërmjet 40 martirëve, kandidatë për nderimet e elterit. (Sipas dëshmisë së Gjovalin Zezajt në librin "Genocid Mesjetar në shekullin XX", Shtypshkronja "Camaj - Pipa", Shkodër, 2001, fq. 45, 46, 56)

Papa: kush ka pushtet, kërkon t'ua mbyllë gojën profetëve, por Shpirti nuk mund të ngujohet në kafaz



Kur kumtohet Ungjilli, shkohet drejt persekutimeve. Këtë pohoi sot Papa Françesku në Meshën e mëngjesit, kremtuar në Kapelën e Shën Martës. Papa kujtoi se sot ka më shumë

martirë, sesa në kohët e para të Kishës dhe u dha zemër besimtarëve të mos tremben nga moskuptimet e as nga persekutimet. RealAudioMP3

Zemra e të prapëve, që largohen nga Zoti, dëshiron ta përvetësojë fenë. Papa e shtjelloi homelinë duke u nisur nga fragmenti i Librit të Urtisë, në Leximin e parë. Prandaj, vërejtje, armiq të Jezusit i ngrejnë kurthe, e mbulojnë me shpifje, bëjnë çmos t'ia zbehin famën. Përgatisin atmosferën për ta shkatërruar të Drejtin. E këtë e bëjnë sepse u kundërvihet veprimeve të tyre, i qorton ata, që shtrembërojnë ligjet, ua vë në dukje drejtpërdrejt shkeljet kundër edukatës, që kanë marrë. Në të gjithë historinë e shëlbimit, vërejtje më tej Papa, profetët kanë qenë gjithnjë të persekutuar. E këtë është vetë Jezusi ai, që ua vë në dukje farizenjve. Gjithnjë në historinë e shëlbimit, në kohën e Izraelit, edhe në Kishë, pohoi, profetët u persekutuan. U persekutuan, sepse e shprehën haptazi mendimin e tyre. U thanë atyre, që po gabonin: ju dredhuat, gabuat rrugë. Kthejuni në rrugën e Zotit! E kjo, vërejtje Ati i Shenjtë, nuk u pëlqen fare njerëzve që kanë pushtet në këtë rrugë të gabuar: **"Ungjilli flet qartë, apo jo? Jezusi fshihej në ditët e**

fundit, sepse nuk kishte ardhur ende ora e Tij: po Ai e dinte si do të mbaronte. Jezusi persekutohet që në orët e para: kujtojmë sesi në fillim të predikimit të Tij kthehet në vendin e vet, shkon në sinagogë e predikon; menjëherë pas admirimit të madh, ia nisin avazit: po ky po na flet, si të mos e dinim nga është. Ky është një prej nesh. Po, me ç' autoritet vjen e na flet kështu? Ku na paska studiuar ky? E shkualifikojnë. Kujtojnë se e dinë nga vjen. Ndërsa, në të vërtetë, askush nuk e di kur vjen e prej nga është! Të shkualifikosh Zotin, të shkualifikosh profetin, për t'i hequr autoritetin".

E këtë e bëjnë, sepse Jezusi dilte vetë e i bënte edhe të tjerët të dilnin nga ky mjedis fetar i mbyllur, nga ky kafaz. Profeti, pohoi Ati i Shenjtë, lufton kundër njerëzve, që duan ta mbyllin në kafaz Shpirtin Shenjt. Prandaj e persekutojnë. Gjithnjë. Profetët, vijoi të reflektojë Papa, janë të gjithë të persekutuar, ose të keqkuptuar, të lënë mënjanë. Nuk u japin kurrë vendin, që meritojnë. E kjo situatë nuk ka përfunduar me vdekjen e me ngjalljen e Krishtit: vijon në Kishë! Të persekutuar nga jashtë e nga brenda. Kur lexojmë jetët e shenjtëve, kujtoi Papa Françesku, shikojnë se edhe ata pësuan sa e sa keqkuptime, sa e sa persekutime, sepse ishin profetë:


"Edhe shumë nga mendimtarët e Kishës u persekutoan. Mendoj, këtë çast, për njerin, që nuk është shumë larg nesh, për një njeri vullnetmirë, profet i vërtetë, që me librat e tij e qorton Kishën, duke i vënë në dukje se po largohet nga rruga e Zotit. E thirrën menjëherë, librat e tij u ndaluan, ia hoqën katedrën, deri sa e përfundoi kështu jetën: jo shumë kohë më parë. Po koha kaloi e ai sot është i Lum! Po si tashti, deri dje ishte heretik e sot i Lum? Puna është se dje ata që kishin pushtet, donin t'ia mbyllnin gojën, sepse nuk u pëlqente ajo, që thoshte. Sot Kisha, që faleminderës Zotit di të pendohet, thotë: 'Jo, ky njeri është i mirë! Për më tepër, është për udhë kah shenjtëria: është i lum'".

Të gjithë njerëzit, që i zgjedh Shpirti Shenjt për t'i thënë të vërtetën Popullit të Hyjit, shtoi, pësojnë persekutime. E Jezusi është pikërisht modeli, ikona. Zoti rëndoi mbi të të gjitha persekutimet e Popullit të vet. E edhe sot, vërejtje me keqardhje të thellë, të krishterët vijojnë të persekutohen. Mund të them se ndoshta sot ka më shumë martirë, sesa në kohët e para të krishterimit, sepse në shoqërinë e botës së sotme, në këtë botë, që dëshiron të jetë e qetë, që nuk i do problemet, thonë të vërtetën, kumtojnë Jezusin:

"Ekziston dënimi me vdekje ose burgu, pse ke në shtëpi Ungjillin, pse jep mësimë katekizmi, e në disa vise të botës. Më tregonte një katolik i këtyre viseve se

nuk munden as të luten së bashku. Është e ndaluar! Mund të luten vetëm, fshehurazi. Po ata duan ta kremtojnë Eukaristinë. E si ia bëjnë? Bëjnë një festë ditëlindjeje, bëjnë sikur po kremtojnë ditëlindjen e kremtojnë Eukaristinë, para se të nisin festën. E, ndodh edhe që në mes të kremtimit të arrijnë policët. Atëhere ata fshehin menjëherë gjithçka e nisin nga urimet: 'Urime, për shumë vjet! Qofsh i lumtur!', për të vijuar festën. Pastaj, sa zhduken policët, rikthehen tek festa e vërtetë, Eukaristia. Duhet të bëjnë kështu, sepse e kanë të ndaluar të luten së bashku. Sot".


E kjo histori persekutimesh, nënvizoi Papa, është udhë e Zotit, udhë e atyre që e ndjekin Zotin. Por, shtoi, pastaj përfundon ashtu si Zoti: me ringjalljen, pas kalimit nëpër udhën e Kryqit, Në përfundim të homelisë, Papa kujtoi atë Mateo Riçin, ungjillëzues i Kinës, që nuk e kuptuan. E megjithatë ai iu bind vetëm zërit të Hyjit, si Jezusi. Do të ketë gjithnjë persekutime, rikujtoi Papa, e edhe keqkuptime. Po Jezusi është Zoti, e kjo është sfida e Kryqit e fesë sonë. Zoti, përfundoi Papa, na dhëntë hirin të ecim në udhën e tij e, në se dëshiron, edhe me kryqin e persekutimeve.



Radio Maria!

Degjoje drejtpërdrejt ne
www.radiomaria.al





Sutton
SUTTON WEST REALTY INC., BROKERAGE

Miranda Bimo
Sales Representative

Bus: 416.240.1000
Cell: 647.294.8826
Fax: 416.240.1603

300-5415 Dundas St. W.
Toronto ON. M9B 1B5

mirandabimo@gmail.com

Independently Owned and Operated.

Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative

Per Shitje, Blerje, Qera Shtëpi, Condo A Po Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethinat)

In House Mortgage Broker 25 Years
Experience Special Rates Through
Violeta and Tony Selmanaj For Fully
Qualified Applicants.

*** Call for Details**

Rates Subject To Change Without Notice and DAC



Direct (416) 553-5044
Office: (905) 279-8300
Email: vselmanaj@trebnet.com

ROYAL LEPAGE Realty Centre, Brokerage*
2150 Hurontario Street Mississauga, ON L5B 1M8

BEQIRI
PROFESSIONAL CORPORATION

Ylli BEQIRI CPA.CGA

Tel: 416-854-9156
Fax: 1-888-838-7736

974 The Queensway,
Toronto ON M8Z 1P6

ybeqiri@sympatico.ca
www.beqiriaccounting.com

